



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
SEKTORI I AUDITIT TË BRENDSHËM

Fushë-Arrëz, me 09/04/2026

Lënda: Dërgim informacioni mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditit i brendshëm në Bashkinë Fushë-Arrëz

MINISTRISË SË FINANCAVE
DREJTORISË HARMONZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM
TIRANË

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i azhornuar, në ligjin nr. 114 datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" i azhduar, si dhe në udhëzimin nr. 42 datë 27.10.2020 "Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditit i brendshëm në Sektorin Publik", bashkëlidhur po ju dërgojmë raportimin vjetor për zbatimin e rekomandimeve të dhëna, e cila përfshin:

1. Formati Standard nr. 1: Formati i Raportit Vjetor të Zbatimit të Rekomandimeve
2. Pasqyra nr. 1: Rekomandimet e dhëna sipas kategorive për vitin 2025.
3. Pasqyra nr. 2: Rregjistri i rekomandimet të auditimit për vitin 2025.

Faleminderit për mirëkuptimin!

PËR SEKTORIN E AUDITIMIT
PËRGJEGJËSE
Entela PEPA

KRYETARI
Hil CURRI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
SEKTORI I AUDITIT TË BRENDSHËM

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në zbatim të nenit 14, të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar, të Planit Vjetor 2025 nr. 3239, datë 08.10.2024, mbështetur në kapitullin X të Manualit të Auditimit të Brendshëm dhe Standardeve Globale të Auditimit të Brendshëm, parimi 15 "Komunikimi i rezultateve të angazhimit dhe monitorimi i planeve të veprimit", me qëllim që të sigurohet mbikëqyrja sistematike mbi impaktin e punës të funksionit të auditimit të brendshëm, (Njësia e Auditimit të Brendshëm) gjatë periudhës Janar-Shkurt 2026 ka realizuar nëpërmjet angazhimit të Monitoruesit, verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e përfunduara gjatë vitit 2025, i cili është angazhuar me iniciativën e Njesisë së Auditimit të Brendshëm në kushtet e mos realizimit të angazhimit të zbatimit të rekomandimeve si rezultat i konfliktit të interesit.

Objekti i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve është vlerësimi i progresit të bërë për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme, si dhe verifikimi i masave të ndërmarra për adresimin e gjetjeve të identifiuara.

Qëllimi i këtij auditimi është të sigurojë se rekomandimet e dhëna nga auditimi i brendshëm janë trajtuar në mënyrën e duhur, brenda afateve të përcaktuara dhe se veprimet korrigjuese kanë kontribuar në përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, të qeverisjes dhe të menaxhimit të riskut.

Objektivat e auditimit synojnë të:

1. Verifikojë statusin aktual të zbatimit të rekomandimeve të mëparshme, duke identifikuar ato që janë:
 - Zbatuar plotësisht: 3 rekomandime (12%)
 - Në proces zbatimi: 8 rekomandime (32%)
 - Pa zbatuar: 14 rekomandime (56%)
2. Vlerësojë cilësinë dhe efektivitetin e veprimeve të ndërmarra, në raport me qëllimin e rekomandimeve.
3. Identifikojë arsyet e mungesës së zbatimit ose të zbatimit të pamjaftueshëm të rekomandimeve, duke adresuar faktorët pengues.
4. Sigurojë informacion të besueshëm për titullarin e njesisë publike, për gjendjen e progresit dhe masat e mëtejshme për përmbushjen e rekomandimeve.

5. Mbështesë procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm, duke ofruar sugjerime të mëtejshme në rastet kur zbatimi është i pamjaftueshëm.

Të dhënat tregojnë një nivel të ulët të zbatimit efektiv të rekomandimeve, pavarësisht pranimi të plotë të tyre. Problematikat kryesore lidhen me vonesa në hartimin e dokumentacionit strategjik, mungesë koordinimi ndërmjet strukturave dhe kufizime në burime njerëzore dhe logjistike.

Rekomandimet janë përqendruar kryesisht në përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe organizimit institucional, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e efikasitetit dhe llogaridhënies. Nga analiza e të dhënave rezulton se, megjithëse ekziston një nivel i mirë pranimi formal i rekomandimeve, implementimi i tyre në praktikë mbetet i kufizuar. Mbi gjysmën e rekomandimeve nuk janë zbatuar, duke evidentuar mangësi në mekanizmat e ndjekjes dhe monitorimit.

Nisur nga niveli i pranimi të rekomandimeve Njësia e Auditimit të Brendshëm ka hartuar dhe pasqyruara sipas Aneksit nr.5 Raportimi Vjetor, seksionin VI.

II. REZULTATET E VLERËSIMIT TË ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË AUDITIMIT

Rekomandimet e propozuara për vitin 2025

Njësia e Auditimit të Brendshëm i ka kushtuar një vëmendje të veçantë procesit të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve. Ky proces është i rëndësishëm pasi mund të kontribuojë në mënyrë thelbësore në përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, në të gjithë komponentët e tij dhe duke patur si qëllim përmirësimin e proceseve të punës.

Gjatë vitit 2025 janë kryer 4 auditime dhe janë dhënë 25 rekomandime për përmirësimin e proceseve të punës më konkretisht:

- 7 rekomandime me nivel të lartë.
- 15 rekomandime me nivel të mesëm.
- 3 rekomandime me nivel të ulët.

Niveli i riskut	Vlera në numër	Vlera në %
I lartë	7	28
I mesëm	15	60
I ulët	3	12
Totali	25	100

Rekomandimet me prioritet të lartë paraqesin nivel të pamjaftueshëm zbatimi, ku një pjesë mbeten të pazbatuara ose vetëm pjesërisht të realizuara, duke rritur ekspozimin ndaj riskut institucional. Rekomandimet me prioritet të mesëm janë kryesisht në proces, por kërkojnë ndjekje më të strukturuar dhe afate më të qarta për përfundimin e tyre. Rekomandimet me prioritet të ulët në pjesën më të madhe nuk janë zbatuar, duke reflektuar fokus të ulët nga strukturat përgjegjëse.

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka kryer angazhime në disa struktura, të cilat në verifikimet e auditimit kanë rezultuar të kenë nivel më të lartë rrisht krahasuar me strukturat e tjera. Subjektet që janë audituar parqiten si më poshtë:

1. Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit të Territorit dhe Emergjencave civile
2. Sektori i MZSH-së
3. Sektori i Policisë Bashkiake
4. Qendra Kulturore e Fëmijëve

Njësia e auditimit ka dhënë 25 rekomandime në total për këto 4 subjekte, rekomandime të cilat janë pranuar plotësisht pa asnjë observacioni, por kjo nuk e justifikon nivelin e ulët të zbatueshmërisë së tyre.

Bazuar në vlerësimin e kryer, konstatohet se niveli i zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm për vitin 2025 është nën nivelin e pritshëm, duke mos garantuar përmirësimin e plotë të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Megjithëse të gjitha rekomandimet janë pranuar nga strukturat përgjegjëse, mungesa e zbatimit efektiv tregon dobësi në menaxhimin e proceseve të ndjekjes dhe në angazhimin institucional për përmirësim të vazhdueshëm.

Në mënyrë të veçantë, problematikat më të theksuara lidhen me:

- Moszbatimin e rekomandimeve me prioritet të lartë;
- Vonesat në ngritjen e sistemeve të menaxhimit të riskut dhe kontrollit të brendshëm;
- Mungesën e mekanizmave të qëndrueshëm të monitorimit dhe raportimit.

Për rrjedhojë, kërkohet një angazhim më i fortë nga drejtuesit e strukturave, forcimi i mekanizmave të ndjekjes dhe rritja e përgjegjshmërisë institucionale, me qëllim përmirësimin e efijencës, transparencës dhe llogaridhënies në Bashkinë Fushë-Arrëz.

III. GJETJET E AUDITIMIT DHE EFEKTIVITETI

Vlerësimi i realizimit të rekomandimeve për vitin 2025 evidenton një progres të pjesshëm dhe jo të balancuar ndërmjet strukturave të audituara, duke reflektuar mungesë të një qasjeje të unifikuar dhe sistematike në ndjekjen e tyre.

Në terma sasiore, niveli i zbatimit paraqitet i ulët, ku një pjesë e kufizuar e rekomandimeve është zbatuar plotësisht, ndërsa një pjesë e konsiderueshme mbetet në proces zbatimi ose nuk është zbatuar brenda afateve të përcaktuara. Kjo situatë tregon për dobësi në planifikimin e masave zbatuese, në monitorimin e progresit dhe në respektimin e afateve të përcaktuara.

Në analizën sipas përmbajtjes, rekomandimet që lidhen me sistemet e kontrollit të brendshëm përbëjnë peshën kryesore dhe përfshijnë elementë thelbësorë si hartimi i strategjive të menaxhimit të riskut, ndërtimi i hartave të proceseve dhe gjurmëve të auditimit, si dhe përmirësimi i praktikave të raportimit dhe dokumentimit. Megjithatë, progresi në këtë drejtim rezulton i fragmentuar dhe jo i konsoliduar, duke evidentuar mungesë kapacitetesh teknike dhe organizative për implementimin e plotë të këtyre kërkesave.

Rekomandimet e karakterit organizativ paraqesin një nivel më të moderuar progresi, veçanërisht në rastet ku janë ndërmarrë iniciativa për riorganizim dhe përmirësim të funksionimit strukturor. Megjithatë, masat që kërkojnë ndërhyrje më të thella institucionale apo vendimmarrje në nivele të larta drejtimi mbeten në pjesën më të madhe të pazbatuara.

Në raport me nivelin e prioritetit, konstatohet se edhe rekomandimet me prioritet të lartë nuk janë zbatuar në mënyrë të plotë dhe në kohë, duke rritur ekspozimin ndaj risqeve institucionale dhe duke kufizuar efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Rekomandimet me prioritet të mesëm shfaqin progres të pjesshëm, ndërsa ato me prioritet të ulët kanë një nivel të ulët adresimi, duke reflektuar mungesë prioritizimi në procesin e zbatimit.

Në tërësi, procesi i ndjekjes së rekomandimeve karakterizohet nga mungesë e mekanizmave të strukturuar të monitorimit, nivele të pamjaftueshme koordinimi ndërmjet strukturave dhe një përgjegjshmëri e kufizuar për mosrealizimin e tyre brenda afateve të përcaktuara.

Përsa i përket kategorizimit të rekomandimeve vërejmë;

1. Rekomandime për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm (15 rekomandime). Kjo kategori përbën pjesën më të madhe të rekomandimeve dhe lidhet me elementë thelbësorë të menaxhimit si; hartimi i strategjive të riskut, dokumentimi i proceseve dhe ngritja e gjurmës së auditimit. Një pjesë e tyre janë në proces zbatimi, por mbeten ende të paplotësuara në mënyrë të plotë dhe funksionale, ndërsa vonesat tregojnë mungesë kapacitetesh dhe prioritizimi nga strukturat përkatëse.
2. Rekomandime të karakterit organizativ (7 rekomandime). Është evidentuar progres i pjesshëm në riorganizimin e strukturave dhe ndarjen e përgjegjësi, por megjithatë, masa të rëndësishme organizative, sidomos ato që kërkojnë ndryshime strukturore apo miratim në nivele më të larta, nuk janë zbatuar.
3. Rekomandime të tjera (3 rekomandime). Këto rekomandime kanë një nivel më të ulët kompleksiteti, por gjithsesi nuk janë zbatuar në masën e duhur, duke reflektuar mungesë ndjekjeje.
4. Rekomandime për kuadrin ligjor dhe arkëtimet. Nuk janë evidentuar rekomandime në këto kategori për periudhën raportuese.

Niveli i ulët i zbatimit të tyre vlerësohet të ketë ardhur si rezultat i faktorëve të mëposhtëm:

- Mungesë e një sistemi efektiv për monitorimin dhe ndjekjen e rekomandimeve;
- Vonesa në hartimin dhe miratimin e dokumenteve strategjike dhe proceduriale;
- Koordinim i pamjaftueshëm ndërmjet strukturave të përfshira;
- Kufizime në burime njerëzore dhe logjistike;
- Nivel i ulët i llogaridhënies për moszbatimin brenda afateve.

Në përfundim të vlerësimit, konstatohet se niveli i zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm për vitin 2025 nuk është në përputhje me standardet dhe pritshmëritë e

përcaktuara nga kuadri rregullator, duke mos siguruar përmirësimin e plotë dhe të qëndrueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm në Bashkinë Fushë-Arrëz.

Megjithëse ekziston një nivel i kënaqshëm i pranimi formal të rekomandimeve, mungesa e implementimit efektiv në praktikë tregon për dobësi në kulturën e llogaridhënies, në menaxhimin e ndryshimit dhe në funksionimin e mekanizmave të ndjekjes institucionale.

Në këtë kontekst, bëhet e domosdoshme ndërmarrja e masave konkrete për forcimin e rolit mbikëqyrës të strukturave drejtuese, rritjen e përgjegjshmërisë institucionale dhe vendosjen e një qasjeje të strukturuar dhe të vazhdueshme për ndjekjen e rekomandimeve, me qëllim garantimin e një përmirësimi të qëndrueshëm të performancës, transparencës dhe llogaridhënies në njësinë publike.

Faleminderit për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin!

SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM
PËRGJEGJËSE

Entela PEPA

Rekomandimet e dhëna sipas kategorive për vitin 2025

Nr.	Rekomandimet e dhëna sipas prioriteteve	REKOMANDIME TË DHËNA NGA AB	REKOMANDIME TË PRANUARA				TOTALI B = b.1 + B.2 + B.3	Rekomandime të papranuara	
			(a) = (b) + (c)			(b)			(c)
			Rekomandim i zbatuar	Në proces zbatimi	Rekomandime të pazbatuara				
I									
REKOMANDIME TË PËRMIRËSIMIT TË SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM									
a)		(a) = (b) + (c)	(b.1)	(b.2)	(b.3)	(b)	(c)		
1	Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit të Territorit dhe Emergjencave Civile	4	-	1	3	4	-		
2	Sektori i MZSH	3	1	1	1	3	-		
3	Sektori i Policisë Bashkiake	2	-	1	1	2	-		
4	Qendra Kulturore e Fëmijëve	6	1	2	3	6	-		
SHUMA 1		15	2	5	8	15	-		
II									
REKOMANDIME TË PËRMIRËSIMIT TË KUADRIT LIGJOR									
1	Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit të Territorit dhe Emergjencave Civile	-	-	-	-	-	-		
2	Sektori i MZSH	-	-	-	-	-	-		
3	Sektori i Policisë Bashkiake	-	-	-	-	-	-		
4	Qendra Kulturore e Fëmijëve	-	-	-	-	-	-		
SHUMA 2		-	-	-	-	-	-		
III									
REKOMANDIME TË KARAKTERIT ORGANIZATIV									
1	Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit të Territorit dhe Emergjencave Civile	3	1	1	1	3	-		
2	Sektori i MZSH	3	-	2	1	3	-		
3	Sektori i Policisë Bashkiake	0	-	-	-	0	-		
4	Qendra Kulturore e Fëmijëve	1	-	-	1	1	-		
SHUMA 3		7	1	3	3	7	-		
IV									
REKOMANDIME PËR ARKËTIME									
1	Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit të Territorit dhe Emergjencave Civile	-	-	-	-	-	-		
2	Sektori i MZSH	-	-	-	-	-	-		
3	Sektori i Policisë Bashkiake	-	-	-	-	-	-		
4	Qendra Kulturore e Fëmijëve	-	-	-	-	-	-		
SHUMA 4		-	-	-	-	-	-		
V									
REKOMANDIME TË TJERA									
1	Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit të Territorit dhe Emergjencave Civile	0	-	-	-	0	-		
2	Sektori i MZSH	0	-	-	-	0	-		
3	Sektori i Policisë Bashkiake	1	-	-	1	1	-		
4	Qendra Kulturore e Fëmijëve	2	-	-	2	2	-		
SHUMA 5		3	-	-	3	3	-		
TOTALI (SHUMA 1+SHUMA 2+SHUMA 3+SHUMA 4+SHUMA 5)		25	3	8	14	25	-		

SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM
PËRGJEGJËSE

Entela PEPA



NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSSHËM NË BASHKINË FUSHË-ARRËZ
Rregjistri i rekomandimeve të auditimit për vitin 2025

Pasqyra nr. 2

Nr.	Rekomandimi	Renditja sipas nivelit	Afati i përcaktuar			Struktura për realizimin e rekomandimeve	Statusi i Rekomandimit	Data e realizimit të rekomandimit	Komente nga audituesi/ subjekti
			Data	Muaji	Viti				
1	Përgjegjësi i Sektorit të MZSH-së të hartojë objektivat, të miratojë strategjinë e riskut, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i rrisqeve që mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të sektorit, të hartojë hartën e proceseve dhe gjurmës së auditimit për të gjitha proceset kryesore të aktiviteteve të këtij Sektorit.	E lartë	31	12	2025	Përgjegjësi i Sektorit të MZSH-së	Pjesërisht		Brenda vitit 2025 dhe në vazhdimësi
2	Bashkia Fushë-Arrëz dhe Drejtoria e Urbanistikës; të riorganizojnë strukturën organizative për të siguruar që IVMT të jetë i pozicionuar si inspektoriat vendor i pavarur, jo si sektor apo varësi e një drejtorie tjetër dhe të hartohen protokolle bashkëpunimi me Drejtorinë e Urbanistikës, Planifikimit të Territorit, Emergjencave Civile dhe Policisë Bashkiake për shkëmbim informacioni me Sektorin e Planifikimit të Territorit, asistencë në terren nga Policia Bashkiake dhe ndërhyrje në raste emergjente me Emergjencat Civile	E lartë	20	9	2025	Bashkia Fushë-Arrëz dhe Drejtoria e Urbanistikës	Zbatuar		Menjëherë
3	Sektori i IVMT-së duhet të hartojë programe vjetore të detajuara dhe të miratuara nga instancat përkatëse, duke përcaktuar qartë subjektet që do të inspektohen, të sigurohet që inspektimet jashtë planit të kufizohen në raste të justifikuara, ku të mos tejkalojnë numrin e	E lartë	31	12	2025	Sektori i IVMT-së	Pa zbatuar		Deri në fund të vitit 2025

	inspektimeve të planifikuara dhe të rritet transparencën përmes raportimeve periodike (mujore, 3-mujore, 6-mujore, vjetore) në mënyrë që të kontribuojnë në forcimin e llogaridhënies dhe besimit publik tek IVMT	E lartë	31	12	2025	Bashkia Fushë-Arrëz dhe Drejtoria e Urbanistikës/Sektorit i Emergjencave Civile	Pjesërisht	Deri në fund të vitit 2025
4	Bashkia Fushë-Arrëz dhe Drejtoria e Urbanistikës/Sektorit i Emergjencave Civile të hartojnë një plan të integruar parajlmërimi në formë të shkruar, që të lidhet funksionalisht me qendrën kombëtare të emergjencave (sistemin 112 me efekt ndërveprimi marrje dhe shpërndarje njoftimi), krijimin e rrjeteve lokale të alarmit (përmes njoftimeve dixhitale, mesazheve celulare ose platformave sociale të menaxhuara nga bashkia) dhe përcaktimin e objekteve për vendstrehim duke i përfshirë në planet e masave të emergjencës, me hartat përkatëse të rrezikut dhe kapacitetit.	E lartë	31	12	2025	Sektori i Policisë Bashkiake	Pa zbatuar	Çdo muaj dhe në vazhdimësi
5	Sektori i Policisë Bashkiake duhet të hartojë planin masave, të hartojë raporte periodike mujore dhe vjetore, të pajiset me bllokun e gjobave dhe të ketë akses të plotë në sistemin elektronik, të pajiset me dokumentacionin mbështetës për çdo rast ndërhijje (kërkesë, urdhër, akt-konstatim, foto), të mbaje në formë zyrtare librin e shërbimit (të ketë të dhëna të detajuara mbi veprimet e kryera, kush jep urdhrin, pëmbajtjen e shkurtër e urdhrit të marrë, kohën e nisjes në shërbim, kryerjen e shërbimit, problemet e evidentuara gjatë kryerjes së shërbimit)	E lartë	22	4	2026	Qendra Kulture e Fëmijëve	Pjesërisht	Brenda vitit 2025
6	Qendra Kulture e Fëmijëve të sigurojë lidhje të ngushtë midis							

	planifikimit, raportimit periodik dhe analizës reale e të thelluar të aktiveit, të riformulojë objektivat sipas metodës SMART për të gjitha programet dhe për drejtorinë, të standartizohet dokumentacioni zyrtar dhe të krijohet një sistem i unifikuar arkivimi (fizik, elektronik audio-viziv) për aktivitetet.	E lartë	22	4	2026	Qendra Kulturore e Fëmijëve dhe Bashkia Fushë-Arrëz	Pa zbatuar		Brenda vitit 2025
7	Qendra Kulturore e Fëmijëve dhe Bashkia Fushë-Arrëz duhet të hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë menjëherë një rregullore të detajuar për transportin e fëmijëve jashtë ambienteve të institucionit, e cila të përfshijë kriteret e sigurisë, përgjegjësitë e personelit shoqërues, raportin shoqërues-fëmijë, procedurat e autorizimit nga prindërit dhe masat për situata emergjente.								
8	Spektori i Policisë Bashkiake duhet të hartojë dhe miratojë strategjinë e rrishtit, me qëllim menaxhimin e rrishtit, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i rrishtit që mund të kenë impakt negativ në arrijtjen e objektivave të sektorit, hartimin e hartës së proceseve dhe gjurmës së auditimit për të gjitha proceset kryesore të aktivitetit të këtij sektori.	E mesëm	31	12	2025	Spektori i Policisë Bashkiake	Pjesërisht		Brenda vitit 2025
9	Qendra Kulturore e Fëmijëve dhe Bashkia Fushë-Arrëz të hartojë dhe miratojë një strategji të rrishtit, me qëllim menaxhimin e rrishtit, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i rrishtit që mund të kenë impakt negativ në arrijtjen e objektivave të Qendrës Kulturore të Fëmijëve, të hartojë hartën e proceseve, gjurmën e auditimit për të gjitha proceset kryesore të aktivitetit të kësaj qendre dhe të	E mesëm	24	4	2026	Qendra Kulturore e Fëmijëve dhe Bashkia Fushë-Arrëz	Pa zbatuar		Deri në fund të vitit 2025

	hartojë raporte periodike 3, 6 dhe 12 mujore në linjën Metodist - Drejtor i Qendrës - Titullar i Institucionit.									Deri në fund të vitit 2025
10	Drejtoria e Burimeve Njerëzore të shtojë një pozicioni të veçantë në strukturën e Qendrës Kulturore të Fëmijëve për përgjegjës/drejtesin artistik, me autoritet dhe përgjegjësi të qarta për planifikimin, koordinimin dhe monitorimin e aktivitetëve artistike dhe festivalet duke bërë një ndarje dhe qartësi të përgjegjësi, ku Drejtori i qendrës të fokusohet në drejtimin administrativ dhe institucional.	E mesëm	31	12	2025	Drejtoria e Burimeve Njerëzore	Pa zbatuar			Deri në fund të vitit 2025
11	Bashkia Fushë-Arrëz dhe Qendra Kulturore e Fëmijëve të sigurojnë shërbimin psikologjik për fëmijët dhe stafin, përmes parashikimit të pozicionit të psikologut në strukturë ose përmes marrëveshjeve të formalizuara të bashkëpunimit.	E mesëm	22	4	2025	Bashkia Fushë-Arrëz dhe Qendra Kulturore e Fëmijëve	Pa zbatuar			Menjëherë dhe në vazhdimësi
12	Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Qendra Kulturore e Fëmijëve të hartojë një plan vjetor për trajnimin e punonjësve dhe zhvillimin e aftësive të tyre profesionale në profilin që përfaqësojnë duke dokumentuar detyrimisht pjesëmarrjen në këto trajnime.	E mesëm	31	1	2026	Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Qendra Kulturore e Fëmijëve	Pjesërisht			Deri në fund të vitit 2025
13	Qendra Kulturore e Fëmijëve duhet të hartojë dhe zbatojë plane individuale në të gjitha profilet për fëmijët lehtësisht të identifikueshëm me aftësi të ndryshme ose vështirësi në të nxënë, duke integruar praktikat ekzistuese të dokumentimit për të garantuar përfshirje të barabartë dhe monitorim efektiv të progresit.	E mesëm	31	1	2026	Qendra Kulturore e Fëmijëve	Zbatuar			Menjëherë
14	Aktivitetet jashtë Qendrës Kulturore të Fëmijëve të zhvillohen	E mesëm	31	12	2025	Qendra Kulturore e Fëmijëve	Pa zbatuar			Deri në fund të vitit 2025

	vetëm sipas kërkesës konkrete për mbështetje të shkollave ose pas një analize të thelluar të nevojave dhe kapaciteteve	E mesme	30	1 dhj	2025	Përgjegjësi i Sektorit të MZSH-së	Zbatuar	Brenda 3 muajve	
15	Sektorit të Shërbimit të MZSH-së duhet të hartojë plane 3, 6 dhe 12 mujore dhe të raportojë çdo muaj pranë strukturave përkatëse të caktuara në raport për realizimin e planit.	E mesme	31	12	2025	Bashkia Fushë-Arrëz	Pjesërisht	Brenda 3 muajve	
16	Bashkia Fushë-Arrëz duhet të plotësojë kushtet e nevojshme për Sektorin e Shërbimit të MZSH-së si uniforma (verë-dimër), veshje speciale, gjenerator, fersibla, prerëse hidraulike, autoshkallë etj., sipas përcatimeve ligjore.	E mesme	31	12	2025	Bashkia Fushë-Arrëz	Pa zbatuar	Deri në fund të vitit 2025	
17	Bashkia Fushë-Arrëz duhet të hartojë një plan për hapjen apo pastrimin e rrugëve pyjore që paraqesin rrezikshmëri për rënie zjarri, si dhe të hartojë një hartë të detajuar me informacionet dhe objektet që rrezikojnë e sigurisht vendosjen e saj në dispozicion të Sektorit të Shërbimit të MZSH-së	E mesme	31	12	2025	Bashkia Fushë-Arrëz	Pjesërisht	Brenda 6 muajve	
18	Bashkisë Fushë-Arrëz duhet të pajisë me dokumentacionin përkatës të qarkullimit automjetet zjarrëfikëse që disponon Sektori i Shërbimit të MZSH-së.	E mesme	31	12	2025	Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit të Territorit, Policisë Bashkiake dhe Emergjencave Civile	Pa zbatuar	Në strukturën e vitit 2026	
19	Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit të Territorit, Policisë Bashkiake dhe Emergjencave Civile duhet të miratojë objektivat sipas kërësive ligjore, strategjinë e rrishtit, me qëllim menaxhimin e rrishtit, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i rrishtit mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të drejtorisë, hartimin e hartës së proceseve dhe gjurmës së auditimit për të gjitha proceset kryesore të aktivitetëve të	E mesme	31	12	2025	Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit të Territorit, Policisë Bashkiake dhe Emergjencave Civile	Pa zbatuar	Në strukturën e vitit 2026	

	kësaj Drejtorie.	E mesme	31	12	2025	Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe IVMT	Pjesërisht		Brenda 3 muajve
20	Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe IVMT të hartojnë dhe zbatojnë një plan trajnimesh të vazhdueshme për stafin inspektues, duke përfshirë njohuri të ligjore, procedurat inspektuese dhe përdorimin e sistemit elektronik "e-Inspektimi", duke monitoruar efektivitetin e tyre në mënyrë periodike	E mesme	20	9	2025	Spektori i IVMT-së	Pa zbatuar		Menjëherë dhe në vazhdimësi
21	Spektori i IVMT-së të nxjerrë vendime përfundimtare për çdo rast ku konstatohet shkelje ligjore dhe këto vendime të publikohen menjëherë në faqen zyrtare të Bashkisë Fushë-Arrëz, vëndpublikimet e Bashkisë dhe në faqen e AKPT-së	E mesme	31	12	2025	Drejtoria e Urbanistikës dhe Bashkia Fushë-Arrëz	Pa zbatuar		Menjëherë dhe në vazhdimësi
22	Drejtoria e Urbanistikës dhe Bashkia Fushë-Arrëz të krijojnë menjëherë një regjistër zyrtar, me format të standardizuar dhe të miratuar me vendim të këshillit bashkiak, i cili të jetë i integruar me sistemin financiar për të lidhur çdo leje me faturën përkatëse, të hartojnë një kalendar raportimi (çdo tre muaj ose gjashtë muaj) me raporte të veçanta mbi lejet e dhëna dhe të publikohen vazhdimisht autorizimet dhe lejet në faqen zyrtare të bashkisë dhe në regjistrin kombëtar, sipas ligjit.	E ulët	20	9	2025	Spektori i Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin	Pa zbatuar		Në vazhdimësi
23	Spektori i Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin duhet të kërkojë të ketë akses në sistemin e- Leje dhe të azhurnojë çdo vit listën e objekteve që ndodhen në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz.	E ulët	24	4	2026	Spektori i Burimeve Njerëzore dhe i Policisë Bashkiake	Pa zbatuar		Brenda 6 muajve
24	Spektori i Burimeve Njerëzore dhe i Policisë Bashkiake duhet të hartojë një program të përhershëm trajnimi, të ngritet bashkëpunimi me Akademinë e Sigurisë apo me								

	institucione të tjera trajnimi publik, të pajisen me uniforma (4 sete – 2 sete pranverore + 2 sete dimërore) dhe mjete logjistike të përcaktuara në dispozitat ligjore për Policinë Bashkiake punonjësit e këtij sektori	E Ulët	22	4	2025	Qendra Kulture e Fëmijëve	Pa zbatuar	Brenda 3 muajve
25	Detyrat e sektorit sportiv të delegohen në formë të shkruar tek një punonjës me aftësi dhe potencial të lartë, për të siguruar mbulimin profesional të aktiviteteve sportive dhe përputhshmërinë me ligjin nr. 139/2015 për zhvillimin dhe promovimin e vlerave kulturore dhe trashëgimisë me interes vendor kryesisht në sferën e lojërave popullore							

Emërtimi	Vlera në numër	Vlera në %
Zbatuar plotësisht	3	12
Në proces zbatimi	8	32
Pa zbatuar	14	56
Totali	25	100

SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM
PËRGJEGJËSE

Entela PEPA

